

NGA MBETJE NË ENERGJI PËR INDUSTRINË E ÇIMENTOS NË BALLKANIN PERËNDIMOR

PËRMIRËSIMI I KORNIZËS LIGJORE PËR BASHKË-PËRPUNIMIN E
MBETJEVE SI LËNDË DJEGËSE ALTERNATIVE NË NIVEL LOKAL DHE
KOMBËTAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

LETËR POZICIONIMI



NGA MBETJE NË ENERGJI PËR INDUSTRIJË E ÇIMENTOS
NË BALLKANIN PERËNDIMOR

LETËR POZICIONIMI

PËRMIRËSIMI I KORNIZËS LIGJORE PËR BASHKË-PËRPUNIMIN E
MBETJEVE SI LËNDË DJEGËSE ALTERNATIVE NË NIVEL LOKAL DHE
KOMBËTAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

CO-PLAN
INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN E HABITATIT
AMU
BASHKIMI I PRODHUESVE SHQIPTAR

Publikuar nga:

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5. rr. Bylis no.12. Kashar, Tiranë, Shqipëri
email: co-plan@co-plan.org, web: www.co-plan.org

AMU, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar

Rr. Vaso Pasha, Nr 7, Tiranë, Shqipëri
info@prodhuesit.org, www.prodhuesit.org

Me mbështetjen e:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Projekti:

"Nga Mbetje në Energji për Industrinë e Çimentos në Ballkanin Perëndimor"

Open Regional Fund for South-East Europe- Modernisation of Municipal Services (ORF-MMS)

Autorë:

PhD.C Rodion GJOKA
MSc. Erni KOCANI
MSc. Elvis NDREKA

Albana Karapanço
Meri Koca
Saina MIZIRI

Dizenjim dhe faqesje:

Klesta Galanxhi

Projekti "Nga Mbetje në Energji për Industrinë e Çimentos në Ballkanin Perëndimor" financohet nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimit të Gjermanisë (BMZ) dhe kompanitë Titan Antea Cement (Shqipëri), Titan Cementarnica Usje (Maqedonia e Veriut) dhe Titan Cementara Kosjeric (Serbi), në kuadër të programit developPPP.de.

Partnerët zbatues të projektit janë Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe fabrikat private të çimentos (Antea Cement, Cementarnica Usje dhe Cementara Kosjeric), në bashkëpunim me Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë (AMU), Qendra Rajonal Mjedisore e Maqedonisë së Veriut (REC) dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Zlatibor (RDA).

Përdorimi, kopjimi dhe shpërndarja e përmbajtjes së këtij dokumenti lejohet vetëm për qëllime jofitimprurëse.

GIZ nuk është përgjegjës për gabime të mundshme në dokument, ose dëme financiare që rezultojnë ose ndonjë dëm tjetër, që vjen nga ose në lidhje me përdorimin e këtij dokumenti.

Përmbajtja

Lista e shkurtimeve	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
1 HYRJE.....	9
2 PËRMBLEDHJE DHE ANALIZË E KUADRIT LIGJOR TË VENDIT	13
2.1 ANALIZA E NIVELIT TË TRANSPOZIMIT.....	13
2.2 KËRKESAT, DETYRIMET DHE KUFIZIMET PËR BASHKË-DJEGJEN E MBETJEVE.....	15
3 DIREKTIVAT E BE-SË DHE TRANSPOZIMI I TYRE NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR	17
4 PROGRAMI I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESUARA	19
5 GJETJET	20
6 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	21
ANEKSI 1 – LISTA E LEGJISLACIONIT TË BE-SË DHE ATIJ SHQIPTAR TË RISHIKUAR	23

Lista e tabelave

Tabela 1: Shkalla e mbulimit të popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta.	10
--	----

Tabela 2: Informacion mbi sasinë dhe përqindjen e mbetjeve që i nënshtrohen proceseve të ndryshme	10
---	----

Lista e shkurtimeve

MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
INSTAT	Instituti i Statistikave
RDF	Lëndëve Djegëse të Refuzuara
SRF	Lëndë Djegëse të Ngurta të Rikuperuara
GHG	Gazet e efektit serë - Greenhouse gas
BAT	Teknikat më të Mira të Disponueshme
ToC	Tabela e Përputhshmërisë - Table of Concordance
BE	Bashkimi European
MNB	Mbetje të Ngurta Bashkiake
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
AKUM	Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta
AMU	Unioni i Prodhuesve Shqiptar
REC	Qendra e Burimeve Mejdimore, Maqedoni e Veriut
RDA	Agjencia për Zhvillim Rajonal, Zlatibor, Serbi

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti “Nga Mbetje në Energjinë për Industrinë e Çimentos në Ballkanin Perëndimor” financohet nga BMZ Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe implementohet nga GIZ, Bashkëpunimi Gjerman në Shqipëri, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut në bashkëpunim me Co-PLAN Insituti për Zhvillimin e Habitatit, AMU, Unioni i Prodhuesve Shqiptar, REC Qendra e Burimeve Mjedisore, Maqedoni e Veriut, RDA Agjencia për Zhvillim Rajonal, Zlatibor, Serbi, me synimin për të eksploruar përdorimin e mundshëm të mbetjeve bashkiake jo të rrezikshme, mbetjeve industriale, gomave të përdorura, mbetjeve nga industria tekstile, në industrinë e çimentos.

Për këtë qëllim, projekti do të analizojë statusin aktual të menaxhimit të mbetjeve në çdo vend, do të vlerësojë potencialin e prodhimit të lëndëve djegëse alternative nga mbetjet e përpunuara në formën e RDF dhe SRF dhe do të lehtësojë bashkëpunimin/marrëveshjet midis aktorëve përkatës në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

Për të eksploruar përdorimin e mbetjeve të përpunuara në industrinë e çimentos dhe për të analizuar gjendjen aktuale të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, u kryen aktivitetet e mëposhtme:

- Rishikimi i Tabelave të Përputhshmërisë për 3 Direktivat e BE-së: Direktiva kuadër e mbetjeve **2008/98/EC**, **Direktiva 2010/75/BE** 'Për shkarkimet industriale', **Direktiva 2015/2193** 'Për kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet me djegie mesatare';
- Analiza e legjislacionit kombëtar, ligjet, akteve nënligjore dhe VKM-ve për sektorin e menaxhimit të mbetjeve;
- Analiza e Dokumentit të Politikave Strategjike 2020-2035 dhe Planit Sektorial.

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri është ende në faze zhvillimi për sa i përket legjislacionit, zbatimit të ligjit në terren dhe infrastrukturës së vendosur për grumbullimin, transportimin dhe trajtimin. Megjithatë janë ndërmarrë hapa të mirë me miratimin e dy dokumenteve strategjike që do të ndihmojnë politikëbërësit të drejtojnë procesin e tyre të vendimmarrjes në lidhje me menaxhimin e mirë të mbetjeve dhe të krijojnë rrjetin e duhur të objekteve të integruara të trajtimit të mbetjeve.

Në fazën aktuale vetëm 3 nga 10 plane rajonale të menaxhimit të mbetjeve janë hartuar dhe shumica e bashkive nuk kanë një plan lokal të menaxhimit të

mbetjeve. Nga ana tjetër, në vend ka vetëm 4 landfille sanitare dhe 1 incenerator operativ (2 në ndërtim e sipër), kështu që lind nevoja për vendosjen e impianteve të trajtimit të mbetjeve për të menaxhuar më mirë mbetjet. Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve nuk zbatohet dhe shkalla e riciklimit është 18,7% në nivel kombëtar. Për faktin se pjesa më e madhe e mbetjeve të grumbulluara depozitohet në landfille, venddepozitime ose vende të pakontrolluara në mjedis, ekziston nevoja për të shqyrtuar përdorimin e mundshëm të mbetjeve të përpunuara në formën e RDF/SRF si lëndë djegëse alternative në fabrikat e çimentos.

Legjislacioni aktual parashikon përdorimin e mbetjeve në impiantet “nga mbetje në energji”, por për momentin nuk ka standarde dhe teknika të specifikuar për prodhimin e RDF/SRF dhe për rrjedhojë nuk ka objekte përpunimi për prodhimin e këtyre lëndëve djegëse. Në këtë linjë ekziston nevoja për të vendosur BAT (Teknikat më të Mira të Mundshme) për prodhimin e RDF/SRF në mënyrë që të përdoret si lëndë djegëse alternative në fabrikat e industrisë së çimentos, dhe gjithashtu duhet të punohet më shumë me komunitetin dhe palët e interesuara për të rritur ndërgjegjësimin për përfitimet e përdorimit të RDF/SRF si alternativë ndaj lëndëve djegëse fosile.

1 HYRJE

Menaxhimi i mbetjeve konsiderohet si një prioritet kyç nga Qeveria e Shqipërisë¹ e cila ka deklaruar se dëshiron ta trajtojë këtë temë në vitet në vijim. Një nga metodat e shfaqura për të adresuar problemet që lidhen me sasinë e mbetjeve bashkiake të depozituara në landfille sanitare ose venddepozitime, apo edhe më e keqja të depozituar në mënyrë të pakontrolluar në mjedis, është përdorimi i mbetjeve të ngurta bashkiake dhe mbetjeve tregtare si lëndë djegëse alternative për tu përdorur në impiantet “nga mbetje në energji”.

Industria e çimentos është e njohur për konsumin e saj të lartë të energjisë si dhe një kontribues i madh në emetimet e CO₂ nga djegia dhe kalcifikimi². Në vitet në vijim industria e çimentos pritet të ulë emetimet e gazrave, ndërkohë që po përpiqet të ulë edhe kostot e prodhimit. Në këtë linjë, përdorimi i mbetjeve të ngurta bashkiake në formën e lëndëve djegëse të refuzuara (RDF) ose lëndëve djegëse të ngurta të rikupëruara (SRF), mbetjeve të gomave të përdorura dhe mbetjeve nga industria tekstile mund të përdoren për të ulur përdorimin e lëndëve djegëse fosile nga industria e çimentos dhe ndërkohë ndikojnë në uljen e sasisë së mbetjeve që depozitohen në venddepozitime, emetimet e gazeve serrë (GHG) dhe konsumin e energjisë.

Përdorimi i RDF/SRF në industrinë e çimentos ose impiante të prodhimit të energjisë nga mbetjet, zbatohet gjithashtu nga shtete anëtare të BE-së si Austria dhe Gjermania, por edhe në Rajonin e Ballkanit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Serbi dhe Bosnje-Hercegovinë. Të dhënat tregojnë se përdorimi i këtij materiali në industrinë e çimentos ka ulur konsumin e energjisë dhe sasinë e mbetjeve që hidhen përfundimisht në landfille.

Qeveria e Shqipërisë ka miratuar së fundmi “Dokumentin e Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planin Kombëtar 2020-2035” (Dokumenti i Politikave Strategjike) i cili është zhvilluar mbi vizionin ose perceptimin e “zero mbetje” dhe parashikon që mbetjet e grumbulluara të menaxhohen në përputhje me konceptin dhe parimet e ekonomisë qarkulluese. Dokumenti i Politikave Strategjike promovon zbatimin e hierarkisë së mbetjeve në të cilën parashikohet rikuperimi i mbetjeve përmes mbetjeve në impiantet energjetike.

¹Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 55/2015, “Mbi Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

²https://setis.ec.europa.eu/system/files/Technology_Information_Sheet_Energy_Efficiency_and_CO2_Reduction_in_the_Cement_Industry.pdf

Sipas të dhënave zyrtare të Institutit Shqiptar të Statistikave (INSTAT), në vitin 2019 shërbimi i menaxhimit të mbetjeve është ofruar për 87.9% të popullsisë me një total prej 2.854.191 banorësh, me një rritje të mbulimit të shërbimit nga viti 2018 ku vetëm 65.7% e popullsisë ishte e mbuluar me shërbim për një popullsi totale prej 2.866.537.

Viti	Popullsia rezidente	Popullsia rezidente që merr shërbim	Niveli i mbulimit me shërbim (%)
2018	2.866.375	1.882.919	65,7
2019	2.854.191	2.508.834	87,9

Tabela 1: Shkalla e mbulimit të popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta.
Burimi i informacionit INSTAT.

Të dhënat tregojnë një ulje të shkallës së gjenerimit për banor nga 1.2 kg/person/ditë në 1.04 kg/person/ditë.

Viti	Energjia e djegur		Djergia për eliminim		Riciklimi		Depozitimi në landfill		Depozitim i lirë		Mbetjet total të menaxhuara		Mbetje të pa menaxhuara		Mbetje të gjeneruar a total
	Ton	%	Ton	%	Ton	%	Ton	%	Ton	%	Ton	%	Ton	%	Ton
2018	36,558	28	25,978	2	245,040	18.5	1,012,517	76.4	4,979	0.4	1,325,071	77	198,185	23	1,523,256
2019	9,732	09	1,744	0.2	203,440	18.7	847,208	77.9	24,538	2.3	1,086,692	90	114,898	10	1,201,598

Tabela 2: Informacion mbi sasinë dhe përqindjen e mbetjeve që i nënshtrohen proceseve të ndryshme

Tabela e mësipërme tregon të dhëna për mbetjet e djegura me ose pa rikuperim energjie, të ricikluara, të depozituara në landfille sanitare dhe josanitare dhe sasinë e mbetjeve të pamënaxhuara, të cilat me gjasë depozitohen në mënyrë të pakontrolluar në mjedis.

Aktualisht, në Shqipëri ka vetëm 4 landfille sanitare për mbetjet jo të rrezikshme, përkatësisht në:

- Landfilli Bushat, i cili shërben për asgjësimin e mbetjeve të qarkut Shkodër dhe Lezhë;
- Landfilli i Sharrës në të cilin depozitohen mbetjet e Bashkisë Tiranë;
- Landfilli i Maliqit, që shërben për depozitim të mbetjeve të qarkut të Korçës, dhe
- Landfilli Bajkaj që shërben për depozitim të mbetjeve të qarkut Gjirokastrë dhe nënzonës së Vlorës Jugore.

Gjithashtu, funksionon një incenerator, i cili shërben për djegien e mbetjeve të prodhuara në qarkun e Elbasanit. Dy inceneratorë të tjerë po ndërtohen përkatësisht në Tiranë, i cili do të shërbejë për trajtimin e mbetjeve të krijuara në bashkitë e Tiranës, Kamzës dhe Durrësit dhe një në bashkinë Fier që do të shërbejë për trajtimin e mbetjeve të krijuara në qarkun e Fierit.

Sipas Dokumentit të Politikave Strategjike janë 199 venddepozitime të paligjshme, ku për trajtimin e mbetjeve të tilla sipas Strategjisë së vjetër për Menaxhimin e Mbetjeve sugjerohet që të trajtohen në impiante të prodhimit të energjisë nga mbetjet.

Për momentin nuk ka impiante për prodhimin e RDF ose SRF, të cilat do të shërbejnë si lëndë djegëse alternative në impiantet e përdorimit të mbetjeve për prodhimin e energjisë, siç janë industritë e çimentos që ndodhen në Shqipëri. Duke marrë në konsideratë sasinë e MNB të prodhuara në vend dhe ato të depozituara në landfille josanitare, ekziston mundësia për ngritjen e impianteve të tilla që prodhojnë RDF dhe SRF në mënyrë të standardizuar dhe të kontrolluar.

Dokumenti i Politikave Strategjike parashikon menaxhimin e mbetjeve të krijuara në Shqipëri nëpërmjet:

- Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve (përfshirë grumbullimin e diferencuar)
- Para-trajtimi (përmes stacioneve të transferimit, impianteve të rikuperimit të materialeve dhe trajtimit mekanik biologjik).
- Rikuperimi (nëpërmjet qendrave të riciklimit për rrjedha të ndryshme mbetjesh, kompostimit dhe mbetjeve në energji).
- Depozitimi përfundimtar (në landfill ose djegia me ose pa rikuperim efikas të energjisë)

Për zbatimin e këtij sistemi menaxhimi, Qeveria e Shqipërisë në bashkëpunim me MIE (institucioni përgjegjës për ndërtimin e infrastrukturës së trajtimit të mbetjeve) duhet të ndërtojë qendra riciklimi, stacione transferimi me trajtime mekanike biologjike për të lehtësuar prodhimin e RDF/SRF. Nga ana tjetër, MTM (përgjegjëse për hartimin e legjislacionit në lidhje me menaxhimin e mbetjeve) duhet të përcaktojë standardet dhe teknikat më të mira të disponueshme (BAT) për prodhimin e RDF/SDF të cilat më pas mund të përdoren në impiantet e prodhimit të energjisë nga mbetjet ose në industrinë e çimentos.

Gjatë takimeve të zhvilluara me përfaqësues të industrive dhe bizneseve të riciklimit, u ngritën shqetësime lidhur me mundësitë e moszbatimit të hierarkisë së mbetjeve, sipas përcaktimeve ligjore dhe detyrimeve përkatëse të secilës bashki. Lidhur me këtë projekt, përveç synimit drejt një zbatimi rigoroz të dispozitave ligjore, dokumenti i Studimit të Tregut ka parashikuar skenarë të dedikuar për reduktimin e mbetjeve, sipas parashikimeve në Planet Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve të bashkive që janë pjesë e projektit.

Kjo siguron që vijimi i prodhimit të lëndëve djegëse alternative të vijojë në koherencë të plotë me përcaktimet e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe detyrimet përkatëse që rrjedhin nga legjisllacioni në fuqi.

2 PËRMBLEDHJE DHE ANALIZË E KUADRIT LIGJOR TË VENDIT

2.1 ANALIZA E NIVELIT TË TRANSPOZIMIT

Analiza në këtë dokument është bërë në kuadër të projektit W2E i cili synon të eksplorojë mundësinë e prodhimit të RDF/SRF si lëndë djegëse alternative në industrinë e çimentos.

Dy direktivat kryesore që rregullojnë përdorimin e mbetjeve në impiantet “nga mbetje në energji” janë:

Dy direktivat kryesore që rregullojnë përdorimin e mbetjeve në impiantet e prodhimit të energjisë nga mbetjet janë:

- Direktiva Kuadër e Mbetjeve 2008/98/EC, e cila rregullon sektorin e menaxhimit të mbetjeve për mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme, dhe
- Direktiva e Emetimeve Industriale 2010/75/BE, e cila përcakton nivelin e emetimeve që industritë duhet të lëshojnë në mjedis.

Direktiva e Mbetjeve 2008/98/KE është transpozuar pjesërisht në Ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”³ i ndryshuar. Ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” është ligji kryesor që kuadron sektorin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Ky ligj është i lidhur ngushtë me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” për sa i takon masave për mbrojtjen e mjedisit. Ligji ndiqet nga disa akte nënligjore dhe VKM që përcaktojnë masat për grumbullimin, transportimin dhe asgjësimin e sigurt të rymave të ndryshme të mbetjeve.

Direktiva 2010/75/BE 'Për emetimet industriale' synon të parandalojë ose eliminojë ndotjen që rrjedh nga aktivitetet industriale në përputhje me parimin 'ndotësi paguan' dhe parimin e parandalimit të ndotjes. Instalimi dhe funksionimi i industrive të tilla do të bazohet në teknikat më të mira të disponueshme (BAT).

Direktiva është transpozuar pjesërisht në legjislacionin shqiptar në akte të ndryshme ligjore si: Ligji nr. 10448 datë 14.7.2011 ‘Për lejet mjedisore’ (Ndryshuar me ligjin nr.52/2020), Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligji nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, VKM nr. 178 datë 6.3.2012 ‘Për incenerimin e mbetjeve’.

³ Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011

Legjislacioni në fuqi në Shqipëri për emetimet industriale të industrive të ndryshme është fokusuar kryesisht në ligjin 'Për lejet mjedisore' me të cilin duhet të pajiset çdo objekt industrial përpara fillimit të funksionimit. Lejet mjedisore ndahen në dy kategori A, B dhe C (sipas ndryshimeve të bëra nga ligji 52/2020 janë vetëm lejet A dhe B) në varësi të tipologjisë dhe ndikimit që mund të kenë në mjedis gjatë funksionimit të tyre. Lidhur me industrinë e çimentos në kuadër të këtij ligji në aneksin 1, industria minerare, seksioni 3.1, për prodhimin e klinkerit në furrat rrotulluese të çimentos: nëse kapaciteti i prodhimit është mbi 500 ton në ditë duhet të jepet leje e tipit A, nëse kapaciteti i prodhimit është e barabartë ose nën 500 tonë në ditë duhet të jepet me leje të tipit B.

Ligji "Për mbrojtjen e mjedisit" transpozon pjesërisht legjislacionin e BE-së. Ligji synon të parandalojë, reduktojë dhe kontrollojë ndotjen e shkaktuar nga aktivitete të caktuara. Ligji parashikon rregullat për zhvillimin e aktiviteteve të caktuara dhe masat e parashikuara për parandalimin e ndotjes. Ligji përcakton edhe tipologjitë e industrive dhe/ose aktiviteteve që duhet të jepen me leje mjedisore në një nga kategoritë A, B të lejeve.

Ligji "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" transpozon pjesërisht legjislacionin e BE-së. Ligji përfshin parimin ndotësi paguan, përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit dhe hierarkinë e mbetjeve në të cilën opsioni i parafundit është përdorimi i mbetjeve ose lëndëve djegëse që rrjedhin nga trajtimi i mbetjeve në impiante energjetike. Sipas ligjit, rikuperimi⁴ është çdo operacion, rezultatet e të cilit:

- mbetjet shërbejnë për një qëllim më të madh, duke zëvendësuar materiale të tjera që përndryshe do të përdoreshin për të përmbushur një funksion të caktuar;
- mbetjet përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një implant.

VKM-ja "Për miratimin e normave të shkarkimit në ajër në Republikën e Shqipërisë" përcakton normat kufitare të shkarkimeve nga prodhimi i çimentos dhe disa materialeve të tjera të ndërtimit, për disa parametra (Lëndë të ngurta, SO₂, NO₂, CO, etj.). Duke qenë një vendim i marrë shumë vite më parë, ai nuk merr parasysh emetimet e shkaktuara nga lëndët djegëse alternative (fraksionet e mbetjeve, RDF, SRF) të cilat mund të përdoren si lëndë djegëse në proceset e bashkëdjegjes.

⁴ Ligji nr. 10463 22.09.2011 'Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve' Neni 2, pika 39.

VKM 'Për incenerimin e mbetjeve'⁵ transpozon Direktivën 2000/76/EC 'Për djegien e mbetjeve' e cila aktualisht është hequr nga BE. VKM-ja synon të përcaktojë kërkesat e detajuara për djegien dhe bashkë-djegien e mbetjeve me ose pa rikuperim energjie. VKM në aneksin 2 përcakton vlerat kufi për shkarkimet e ajrit nga bashkëdjegia e mbetjeve në furrat e çimentos.

Dokumenti i Politikave Strategjike thekson nevojën për krijimin e një rrjeti të integruar të objekteve të menaxhimit të mbetjeve duke përfshirë impiantet e selektimit, stacionet e transferimit me ose pa trajtim mekanik dhe biologjik, landfillë dhe inceneratorë. Dokumenti detyron autoritetet kompetente të hartojnë Planet Rajonale dhe Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve.

Nga ana tjetër, "Plani Sektorial Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta" (Plani Sektorial), përcakton investimet infrastrukturore kombëtare dhe rajonale dhe ndarjen e fondeve për infrastrukturën përkatëse. Plani Sektorial merr në konsideratë infrastrukturën aktuale dhe të ardhshme të menaxhimit të mbetjeve dhe e ndan territorin në 10 zona të menaxhimit të mbetjeve (ZMM). Ky dokument jep një pasqyrë të metodologjisë dhe teknologjisë për impiantet e ardhshme të trajtimit të mbetjeve.

Është e nevojshme që qarqet dhe bashkitë të hartojnë planet e menaxhimit të mbetjeve në përputhje me Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Sektorial.

2.2 KËRKESAT, DETYRIMET DHE KUFIZIMET PËR BASHKË-DJEGIEN E MBETJEVE

Puna e impianteve që gjatë funksionimit të tyre shkaktojnë ndotje në mjedis duhet të pajiset me leje mjedisore të tipit A, B në varësi të madhësisë dhe llojit të veprimtarisë. Më konkretisht funksionimi i industrisë së çimentos është parashikuar në ligjin "Për lejen mjedisore". Industria e çimentos përfshihet në, Industria minerare, seksioni 3.1, për prodhimin e klinkerit në furrat rotulluese të çimentos: nëse kapaciteti i prodhimit është mbi 500 ton në ditë duhet të pajiset me leje të tipit A, nëse kapaciteti i prodhimit është i barabartë ose nën 500 tonë në ditë duhet të pajiset me leje të tipit B. Nëse industria e çimentos dëshiron të përdorë mbetjet si lëndë djegëse alternative gjatë veprimtarisë së saj, atëherë ato duhet të jenë në përputhje me **nenin 47** të ligjit "Për menaxhimin e integruar të

⁵ No. 178, dated 06 March 2012

mbetjeve" për djegien dhe bashkëdjegien e mbetjeve. Nga ana tjetër, më shumë specifika për masat dhe emetimet kufi për përdorimin e mbetjeve në industrinë e çimentos jepen në VKM 'Për incenerimin e mbetjeve' në Aneksin II, përcaktimi i vlerave kufi të shkarkimeve në ajër për bashkëdjegien e mbetjeve, seksioni II. - dispozita të veçanta për furrat e çimentos që bashkë-djegin mbetjet.

Nëse një objekt ose një industri çimentoje në këtë rast, dëshiron të ndryshojë objektin e punës ose tipologjinë e mbetjeve të djegura, atëherë duhet të aplikojë për një leje të re mjedisore në përputhje me VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të veçanta për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisore të llojeve A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga njëra-tjetra, kushtet për lejet e respektimit të mjedisit, si dhe rregulla të detajuara për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga qendra kombëtare e licencimit".

Aktualisht në zonën e studimit nuk ka asnjë stacion transferimi të ndërtuar, i cili mund të shërbejë si ambiente për ruajtjen dhe trajtimin e përkohshëm të mbetjeve. Mungesa e këtyre objekteve nuk lejon zhvillimin e studimeve për zbatimin e teknologjive dhe proceseve të trajtimit të mbetjeve, Teknikat më të mira të disponueshme, për prodhimin e lëndëve djegëse alternative në formën e RDF/SRF të cilat për pasojë mund të përdoren nga fabrikat e çimentos si lëndë djegëse alternative në proceset e tyre të punës.

Nga takimet e zhvilluara me përfaqësues të MIE, AKUM, Co-PLAN, u tha se po zhvillohen studimet e fizibilitetit në lidhje me ndërtimin e disa stacioneve të transferimit të mbetjeve në zonën e studimit. Puna për projektimin dhe ndërtimin e objekteve të tilla duhet të kalojë në një proces gjithëpërfshirës dhe të konsultohet me të gjithë aktorët kryesorë të sektorit dhe më konkretisht me përfaqësues të industrisë së riciklimit që janë faktor kyç në zbatimin e hierarkisë së mbetjeve.

3 DIREKTIVAT E BE-SË DHE TRANSPOZIMI I TYRE NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

Legjislacioni aktual në Shqipëri parashikon hierarkinë e mbetjeve si një rend preference për menaxhimin e mbetjeve. Kjo është në përputhje me kuadrin ligjor të BE-së. Vendi ka bërë përparim në transpozimin e direktivave të BE-së në legjislacionin kombëtar. Në kuadrin e menaxhimit të mbetjeve, vendi ka një kuadër të gjerë ligjor që përbëhet nga akte ligjore dhe nënligjore, vendime të këshillit të ministrave dhe akte të miratuara nga ministritë, agjencitë kombëtare dhe inspektoriatet, bashkitë dhe drejtoritë rajonale.

Shtojca 1 përmban një listë të akteve ligjore të vendit, në lidhje me tre direktivat e sipërpërmendura që janë shtyllat referuese. Për sa i përket nivelit të transpozimit, përafrimi i ligjeve kombëtare me Direktivën Kuadër të Mbetjeve 2008/98, Direktivën 2015/2193 Për kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet me djegie mesatare, dhe Direktivën 2010/75 për shkarkimet industriale, është analizuar nen për nen dhe është pasqyruar në Tabelat e Përputhshmërisë (ToC).

Shqyrtimi i plotë i secilës direktivë dhe ligjeve kombëtare, tregon sa vijon:

a) Direktiva për mbetjet 2008/98/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian “Për mbetjet dhe shfuqizimin e disa direktivave” është transpozuar plotësisht në legjislacionin e brendshëm shqiptar, pikërisht Ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

ToC për këtë direktivë tregon se::

- i) 26 nene nga 43 janë transpozuar plotësisht;
- ii) 4 nga 4 anekset janë gjithashtu të transpozuar plotësisht;
- iii) 1 nen nga 43 nuk është transpozuar, përkatësisht neni 20 për “Mbetjet e rrezikshme të prodhuara nga familjet”.

Nenet që nuk janë transpozuar u drejtohen Shteteve Anëtare ose institucioneve të BE-së. Në këtë këndvështrim, Shqipëria nuk është e detyruar t'i transpozojë ato në këtë moment.

b) Direktiva 2010/75/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 24 nëntor 2010 “Për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes)”.

ToC për këtë direktivë tregon se:

- i) 10 nga 84 nene janë transpozuar pjesërisht;
- ii) 74 nga 84 shtojca ose nuk janë transpozuar ose nuk janë të zbatueshme.

- iii) Konstatohet se kjo direktivë nuk është transpozuar në legjislacionin kombëtar shqiptar.

c) Direktiva 2015/2193 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit “Për kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet me djegie mesatare”

ToC për këtë direktivë tregon se kjo direktivë nuk është transpozuar në ligjin kombëtar, me përjashtim të disa prej neneve që gjenden në tre ligje të ndryshme, përkatësisht:

- i) 2 nga 20 nene janë transpozuar pjesërisht në:
 - Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisore”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

Këta dy nene janë neni 2 “Qëllimi” dhe neni 3 “Përkufizime”.

- i) 18 nga 20 nuk janë transpozuar;
- ii) 3 nga 3 anekset nuk janë transpozuar.

Konkludohet se ka një transpozim të shpërndarë të disa neneve që nuk ndihmojnë në arritjen e plotë të synimeve të përcaktuara nga direktiva.

4 PROGRAMI I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESUARA

Vitet e fundit në Shqipëri është zhvilluar një diskutim i përgjithshëm në lidhje me djegien, bashkëdjegien e mbetjeve me ose pa rikuperim energjie. Ndërtimi i inceneratorëve u pasua nga debate publike midis publikut të gjerë, OJQ-ve mjedisore dhe autoriteteve publike, të cilat kanë lënë shumë paqartësi te qytetarët për kostot e funksionimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Nga metje në energji është një koncept relativisht i ri për Shqipërinë dhe për ta bërë atë më të kuptueshme dhe më të pranueshme për publikun e gjerë, OJQ-të, kompanitë e riciklimit, autoritetet në nivel kombëtar dhe lokal, është e nevojshme të fillohet një proces diskutimi dhe konsultimi për të ndarë të praktikat e mira nga vende të tjera evropiane dhe ballkanike. Një nga lëndët djegëse alternative të përdorura në industrinë e çimentos për të reduktuar konsumin e lëndëve djegëse fosile janë lëndët djegëse që rrjedhin nga mbetjet (RDF) dhe lëndët djegëse të ngurta të rikuperuara (SRF) të cilat përftohen nga trajtimi dhe klasifikimi i MNB dhe mbetjeve industriale.

Për të shkëmbyer njohuritë dhe praktikat më të mira për aplikimin e RDF/SRF në impiantet 'nga mbetje në energji' dhe për të rritur ndërgjegjësimin e palëve të interesuara, parashikohet të zbatohen një sërë aktiviteteve gjatë fazës së zbatimit të projektit. Angazhimi aktiv i palëve të interesuara mund të bëhet përmes:

- Takime formale me përfaqësues të pushtetit qendror dhe lokal, komunitetet e prekura, grupet vulnerabël, institucionet arsimore, përfaqësues të kompanive të riciklimit, sektorit privat dhe OJQ-ve;
- Organizimi i seminareve me përfaqësues të pushtetit qendror dhe pushtetit lokal, autoriteteve publike, përfaqësues të kompanive të riciklimit, industrisë dhe OJQ-ve;
- Deklarata për shtyp për të ndarë informacionin me një publik më të gjerë;
- Udhëtime në terren me përfaqësues të aktorëve kryesorë në impiantet e përdorimit të mbetjeve për energji për të ilustruar procesin;
- Shkëmbimi i informacionit përmes rrjeteve sociale dhe buletineve periodike;
- Konsultimi publik në internet dhe ballë-për-ballë me palët e interesuara;
- Promovimi i dialogut ndërmjet sektorit publik dhe privat.

5 GJETJET

Gjetjet e analizave të bëra mbi legjislacionin kombëtar dhe legjislacionin e BE-së në lidhje me përdorimin e lëndëve djegëse alternative nga mbetjet, RDF/SRF, në impiantet e prodhimit të energjisë nga mbetjet dhe të fokusuara në industrinë e çimentos janë si më poshtë:

- Pjesa më e madhe e legjislacionit të BE-së në lidhje me temat e trajtuara në këtë letër pozicionimi janë të rregulluara;
- Rrjeti i integruar i impianteve të menaxhimit të mbetjeve nuk është krijuar për një pjesë të territorit të vendit;
- Hierarkia e mbetjeve nuk zbatohet;
- Planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve nuk janë hartuar për të gjitha qarqet dhe bashkitë e vendit;
- Bashkitë të cilat kanë hartuar planet e menaxhimit të mbetjeve, nuk kanë përfshirë skenare/opsione të rikuperimit të energjisë, si pjesë të tyre;
- Për sa i përket përdorimit të mbetjeve në industrinë e çimentos, procesi rregullohet nëpërmjet ligjit “Për lejen mjedisore” dhe VKM “Për incenerimin e mbetjeve”;
- Ekziston nevoja për rishikimin/përditësimin e VKM-së ‘Për incenerimin e mbetjeve’ pasi Direktiva që transponon kjo VKM nuk është më në fuqi;
- BAT për prodhimin e RDF/SRF nuk janë hartuar;
- Nuk ka kompani të licencuara në vend për prodhimin e RDF/SRF;
- Për momentin ka një sasi të madhe mbetjesh që përfundojnë në landfille, venddepozitime ose ambjente të hapura dhe të pakontrolluara;
- Ka gatishmëri nga kompanitë që operojnë në industrinë e çimentos për të përdorur RDF/SRF si lëndë djegëse alternative;
- Dokumenti i Politikave Strategjike mbështet veprimet për kalimin nga ekonomia lineare në atë qarkulluese në sektorin e mbetjeve;
- Legjislacioni aktual edhe me aplikimin e hierarkisë së mbetjeve lejon dhe mbështet përdorimin e mbetjeve në mbetje në impiantet e energjisë si opion i parafundit i hierarkisë;
- Rritja e ndërgjegjësimit ndërmjet palëve të interesuara për përfitimet e përdorimit të RDF/SRF në mbetjet për impiantet e energjisë.

6 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në fazën aktuale Shqipëria po përmirëson qasjen e saj në lidhje me sektorin e menaxhimit të mbetjeve dhe miratimi i dy dokumenteve strategjike dëshmon disponueshmërinë e Qeverisë së Shqipërisë për të arritur standarde më të mira mjedisore. Nga ana tjetër, politika e BE-së për mbetjet synon të kontribuojë në një ekonomi qarkulluese duke nxjerrë sa më shumë burime të cilësisë së lartë nga mbetjet. Në këtë linjë përdorimi i mbetjeve të përpunuara si lëndë djegëse alternative në impiantet që prodhojnë energji nga mbetjet dhe industritë e çimentos, do të përmbushë të dyja kërkesat e vendosura nga Qeveria e Shqipërisë dhe BE.

Siç parashikohet nga Dokumenti i Politikave Strategjike, përdorimi i mbetjeve në impiantet e prodhimit të energjisë nga mbetjet do të përmbushë një nga fazat e hierarkisë së mbetjeve dhe do të ndihmojë në reduktimin e mbetjeve të depozituara në landfille dhe venddepozitime të tjera, nga ana tjetër mbetjet e përpunuara në formën e RDF/SRF do të përdoren si lëndë djegëse alternative në fabrikat e çimentos.

Aplikimi i këtyre aktiviteteve do të:

- ndihmojë të arrihet një menaxhim më i mirë i mbetjeve,
- japi vlerë mbetjeve, si një produkt që mund të shitet dhe të përfitohet prej tyre,
- nxisë krijimin e një rrjeti të impianteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve,
- lehtësojë marrëveshjet ndërmjet kompanive publike dhe private në sektorin e mbetjeve,
- reduktojë përdorimin e lëndëve djegëse fosile dhe
- ndihmojnë në ngritjen e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Për të funksionuar sistemin, nevojitet nga institucioni përgjegjës, MTE, që të zhvillojë BAT për prodhimin e RDF/SRF dhe të lehtësojë/promovojë marrëveshjet ndërmjet kompanive private që punojnë në sektorin e mbetjeve, ndërmarrjeve publike (brenda strukturës së bashkive) në detyrat e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve me impiante të prodhimit të energjisë nga mbetjet.

Duhet të bëhen disa ndryshime në VKM “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”, duke shtuar kufijtë e emetimeve të ndotësve të krijuar nga përdorimi i lëndëve djegëse alternative.

Paralelisht me këtë duhet të hartohet baza ligjore e nevojshme për të lejuar dhe standardizuar prodhimin dhe përdorimin e lëndëve djegëse alternative dhe Direktiva 2010/75 / BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 24 nëntor 2010 "Për emetimet industriale (parandalimi i integruar i ndotjes dhe kontrolli)" duhet të transpozohet dhe zbatohet së bashku me miratimin e BAT (Teknikat më të mira të disponueshme) përkatëse.

Nga ana tjetër, është e nevojshme të ndërgjegjësohet publiku për përfitimet e përdorimit të mbetjeve të përpunuara si lëndë djegëse alternative në impiantet e prodhimit të energjisë nga mbetjet, të cilët do të lejojnë kalimin e sektorit të mbetjeve nga një ekonomi lineare në atë qarkulluese.

ANEKSI 1 – LISTA E LEGJISLACIONIT TË BE-SË DHE ATIJ SHQIPTAR TË RISHIKUAR

DIREKTIVA TË BE

- Direktiva Kuadër për Mbetjet 2008/98/EC
- Direktiva e Emetimeve Industriale 2010/75/EU

LEGJISLACIONI SHQIPTAR

- Ligji nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i rishikuar;
- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i rishikuar;
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i rishikuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rishikuar;
- Ligji nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për efencencën e energjisë”, i rishikuar.

VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

- VKM 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”
- VKM nr.319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”.
- VKM 687, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve” pjesërisht e përafruar me rregulloren (KE) Nr 2150/2002, 25 Nëntor 2002 “Për statistikën e mbetjeve”.
- VKM nr. 178, datë 06.03.2012 “Për incenerimin e mbetjeve” i cili ka transpozuar Direktivën 2000/76 EC, 4 Dhjetor 2000.
- VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”
- VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfillet e mbetjeve”;
- VKM 435 datë 12.9.2002 " Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- VKM nr.412, datë 19.06.2019 “Për miratimin e Planit Kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
- VKM nr. 594, datë 10.9.2014 “Për miratimin e Strategjisë së Kombëtare të cilësisë së ajrit”;
- VKM nr.431, datë 11.07.2019 “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve”.

